



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**

Nr. 1616/14 Prot

Shkodër, me dt. 02.11.2023

**NJOFTIM**

**L ë n d a:** Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive pozicioni “ **Nëpunës civil, në Zyrën e Shërbimit Mbështetës Pukë** pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër , kategoria ekzekutive IV- 2”.

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

**KËSHILLIT TË GJYKATËS SË SHKALLË SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimit nr. nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Shkresës nr. 1616/1 prot datë 17.10.2023, për shpalljen e vendit “ **Nëpunës civil, në Zyrën e Shërbimit Mbështetës Pukë**, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria ekzekutive IV- 2:

Konstatojmë se në përfundim të afatit (datë 31.10.2023) , në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive në pozicionin “**Nëpunës civil, në Zyrën e Shërbimit Mbështetës Pukë**” pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër , kategoria ekzekutive IV- 2, rezulton se është paraqitur një kandidaturë e cila i plotëson kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta dhe të përgjithshme konkretisht:

**1. Angjelin Deda**

Në këto rrethana bazuar në nenin 9 dhe 11 të Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” dhe kreut II, pika “5” të Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” procedura për ngritje në detyrë në shërbimin civil gjyqësor do të vazhdojë me vleresimin profesional i cili **do të zhvillohet në përputhje**

**me pikën 7 të këtij udhëzimi** në ambjentet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KANCELARE**

**Valbona SULEJMANI**

